




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 22.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 20.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "IDEA EET" Sh.p.k, Duhël- Suharekë, me perfaqesues Avni Elshani lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500 ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.** me nr te prokurimit 613-20-5228-121 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pa e bazuar kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar nga Operatori Ekonomik "IDEA EET" Sh.p.k, Duhël Suharekë me perfaqesues Avni Elshani për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.** me nr te prokurimit 613-20-5228-121 ,
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos të vazhdoi me aktivitetin e prokurimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët e interesuara në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Operatori Ekonomik "IDEA EET" Sh.p.k, Duhël- Suharekë, me perfaqesues Avni Elshani, për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.** me nr te prokurimit 613-20-5228-121, me datë 20.12.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e lartpërmendur. Autoriteti Kontraktues, me datë 22.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi 1 Sa i përket kërkesës së juaj për qasje në dokumentacion, këtë ju kam lejuar menjëher edhe përkundër volumit të madh të punëve që kemi në këtë fundviti dhe gjithashtu me staf të reduktuar. Pse nuk keni ardhë në kohën e caktuar për qasje në dokumentacion nuk është tragjike, por keni mund të na telefononi se në orën e caktuar nuk mund të vi, por na i caktoni një termin tjetër për atë ditë. Qasje në dokumentacion keni pasë edhe herën e parë dhe se ai dokumentacion nuk ka ndryshuar (i njëjti është). Bile jo njëherë por keni qenë disa herë gjatë vlerësimit të parë duke u munduar që të ndikoni në rezultatin e vlerësimit. Ky pretendim i juaj, është plotësisht i pabazuar dhe tendencioz



Pretendimi 2 Në vlerësimin e parë kemi shpërbly një OE me çmim më të lartë e tek rivlerësimi kemi shpërblyer një OE me çmim më të ulët, e nuk ju kemi shpërblyer juve, ashtu siç keni pretenduar ju. Rivlerësimi është plotësisht i pavarur nga vlerësimi i parë. **Ky pretendim i juaj, është plotësisht i pabazuar dhe tendencioz**

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.12.2020 ka shqyrtuar kërkesën e juaj dhe ka konstatuar se kërkesa juaj është e pabazuar

Me rastin e Ri-Vlerësimit të tenderëve, edhe Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes, sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë, por që nuk ishte i suksesshëm, ngase nuk ishte me çmim më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe në dosje të tenderit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

